



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.564/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e Partia e Ashkalinjve për Integrim (PAI) dhe Egzonit Jakupi, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik (PAI), dega në Lipjan, paraqitur kundër vendimit me numër 860-2021 të datës 04.03.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shpalljen e rezultatisht përfundimtar, për shkak të parregullsive në plotësimin e FPR-së, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 05.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohen të bazuara apelet me numër Anr.564 dhe Anr.565, të datës 04.03.2021, e parashtruara nga subjekti politik Partia e Ashkalinjve për Integrim (PAI) dhe Egzonit Jakupi, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik (PAI), dega në Lipjan, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me numër 860-2021 i datës 04.03.2021, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme, për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 14.02.2021.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për deputet nga radhët e subjektit politik PAI, në vendvotimin: 1315E/ 01D në Lipjan.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kuti në Vendvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

IV. Kryesuesit të Vendvotimit 1315e/01D Qëndrim Gashi me nr. të letërnjoftimit 1174725493, si dhe anëtarëve të këtij vendvotimi Shaqir Shaqiri me nr. të letërnjoftimit 1173148140, Naime Bytyqi me nr. të letërnjoftimit 1173140360, Milaim Xhema me nr. të letërnjoftimit 1014988242, Arbenita Qerimi me nr. të letërnjoftimit 1243000986, Mexhide Rrahmani me nr. të letërnjoftimit 1242699498, Jeton Goliqi me nr. të letërnjoftimit 1175650799, i ndalohet pjesëmarrja në zgjedhje në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite si kandidat dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelet me numër Anr.564/2021 dhe Anr.565/2021 të datës 04.03.2021, nga subjekti politik Partia e Ashkalinjve për Integrim (PAI) dhe Egzonit Jakupi, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik (PAI), dega në Lipjan. Në apelin Anr.564/2021 subjekti

politik PAI pretendon se kandidatët e këtij subjekti politik me numër 2 dhe 3, pas marrjes së rezultateve sipas FPR-ve në Qendrën e Lipjanit me numër 22, në vendvotimin nr.1315E/01D, sipas tyre kanë votuar 57 votues, të komunitetit ashkali. Mëtutje në apel pretendojnë se kandidati me numër 2 ka pasur 54 vota kurse kandidati me numër 3 ka pasur 43 vota, në të cilat mendojnë se janë ndryshuar në FPR dhe dikush nga komisionerët ka ndërhyrë dhe ka shënuar mbi këta numra, ku kandidati me numër 2 ka 3 vota, ndërsa kandidati me numër 3, ka 6 vota. Në apelin Anr.565, kandidati për deputet Egzonit Jakupi nga radhët e subjektit politik PAI pretendon se pas marrjes së rezultateve sipas FPR-ve në të njëjtën vendvotim 1315E/01D në Qendrën e Lipjanit me numër 22 kanë votuar 57 votues, të komunitetit ashkali. Në vazhdim të apelit ka pretenduar se gjatë plotësimit të FPR-së kandidati për deputet me numër 4 ka pasur 19 vota dhe sipas tij dikush nga komisionerët ka ndërhy dhe ka shënuar mbi këta numra ku nga 19 vota ka rezultuar 0 vota. Parashtruesit e apeleve kanë bashkangjitur në cilësinë e provës kopjen e FPR-së së VV me numër 1315E/01D, Lipjan. Kërkojnë nga PZAP-i që të verifikohet dhe korrigjohet FPR-ja e VV me numër 1315E/01D për kandidatët për deputet me numër 2,3 dhe 4 nga radhët e subjektit politik PAI.

Paneli, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar apelet e lartcekura dhe i trajton si një apel i evidentuar me Anr.564/2021, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për tri apele që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato apele të trajtohen me një vendim i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

Apelet janë të bazuara

Paneli, me datë 04.03.2021, në përbërje të ekipit hetues të PZAP-it, ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore the gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për Kutin e Votimit 1315E/01D, është konstatuar se fleta origjinale e Formularit të Rezultateve për Kandidat (FRK), të subjektit politik me nr. 130 (PAI), të kandidatët me numër 2, 3 dhe 4 shihen se i kanë votat sikurse në apel, ndërsa te fleta kopje (ngjyra rozë) kandidati me numër 2 i ka 3 vota, kandidati me numër 3 i ka 6 vota. Anëtarët e KVV-së, janë nënshkruar vetëm te kopja, e jo te origjinali i FRK-së. Ndryshimi shihet se është bërë në kopje e jo në origjinal, mirëpo për bazë merren të dhënat nga fleta origjinale (ngjyra e bardhë).

Pas numërimit të fletëvotimeve të subjektit politik PAI, del se kandidati me nr. 2 Bekim Arifi i ka 55 vota, ndërsa në FRK i ka 54 vota, tek kandidati me nr. 3 Nasibe Bajrami numri i votave në rezultat përfundimtar përputhet si në FRK edhe pas numërimit të votave në fletëvotim. Kurse kandidati me nr. 4 Egzonit Jakupi, pas numërimit të fletëvotimeve, ka 17 vota, ndërsa në FRK i ka 19 vota.

Andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët për deputet nga radhët e subjektit politik (PAI), dega në Lipjan, për vendvotimin e lartcekur, ashtu që rezultati i dal nga ky rinumërim ti bashkëngjitet rezultatit përfundimtar.

Me rastin e vendosjes si në pikën -IV-, të dispozitivit të këtij vendimi, përkitazi me masën e shqiptuar për ndalim të kryesuesit të vendvotimit dhe anëtarëve të vendvotimit të cilët janë nënshkruar në FRK, për pjesëmarrje në zgjedhje në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, si kandidat dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), kjo është marrë në bazë të nenit 120 par. 3, pika d) i LZP-së. Përgjegjësia e Kryesuesit rrjedh nga fakti se kryesuesi i çdo Vendvotimi është përgjegjës për sigurinë e integritetit, dhe të qetësisë në procesin e votimit dhe numërimit në vendvotim gjatë ditës së votimit, sipas dispozitës ligjore të nenit 74 par. 10 të LZP-së, ndërsa përgjegjësia e anëtarëve që kanë nënshkruar FRK me shkeljet e evidentuara më lart rrjedh nga fakti i dhënies së pëlqimit me veprim konkludent, me vendosje të nënshkrimit. Në rastin konkret paneli ka vërtetuar se kryesuesi i vendvotimit në fjalë dhe anëtarët kanë bërë shkelje të dispozitës së sipërcituar sepse parashtruesit të ankesës nuk i janë paraqitur fletëvotimet në FRK ashtu si ishin në kutinë e votimit dhe kjo nënkuptohet si devijim i vullnetit të votuesve.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 564/2021 më datën 05.03.2021

Kryesuesi i Panelit
Adnan Konushevi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.